

Niveli i depresionit tek pacientet me Helikobakter Pylori

Dorand Isufaj¹, Dua Danjoli²

Abstrakti

Hyrje: Depresioni është një sëmundje e zakonshme dhe serioze mjekësore që ndikon negativisht në shëndetin tone. Bakteria *Helikobakter Pylori* u zbulua si bakter i dëmshëm për traktin digjektiv.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të matet niveli i depresionit tek pacientët me *Helikobakter pylori* pozitiv.

Metodologjia: Në këtë hulumtim është përdorur metoda kuantitative e realizuar me anë të pyetësorëve. Gjithsej janë grumbulluar 70 pyetësorë, ku 59% e të anketuarve ishin meshkuj, ndërsa 41% ishin femra. Të anketuarit i kanë takuar grupmoshës 20-30 vjeç (44%), 30-40 vjeç (32%), ndërsa 40-50 vjeç (24%). Për analizimin e të dhënave është përdorur paketa statistikore SPSS 21.

Rezultatet: Nga analizimi i të dhënave rezultojmë që ka një signifikançë mes moshës dhe nivelit të depresionit, ku vlera e $p < .000$. Në grupmoshën 20-30 janë shprehur batica dhe zbatica normale në jetën e tyre dhe është hasur niveli i para depresionit klinik. Tek të anketuarit janë shprehur shqetësimet për probleme fizike të tilla si dhimbjet, çrregullimet e organizimit apo kapslllek. Sipas analizimit të të dhënave rezultojmë se pacientet me *H. pylori* e kanë më të vështirë që të marrin vendime dhe janë më të dekurajuar për të ardhmen e tyre jetësore.

Rekomandimet: Rekomandohet që të kushtohet më shumë vëmendje tek indikatorët të cilët kanë predispozita për ta rritur nivelin e depresionit dhe të kushtohet një rëndësi e madhe në periudha të caktuara të moshës kur ata janë të diagnostifikuar me ndonjë sëmundje e cila mund të ketë ndikim në nivelin e depresionit.

Fjalët kyçe: Depresioni, *H. Pylori*